

Te dhënat për projektet,nismat dhe veprimtaritë e bashkisë në kuadrin e integritit në BE.

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, shkronja “c”, të neneve 10,11, 12, dhe 30, pika 3 të ligjit nr .139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave NR.450 datë 26.07.2018, me urdhërin e datës 11.02.2019 u vendos krijimi I strukturës së Integritit Evropian dhe Ndihmës së Huaj.

Veprimtaritë e Bashkisë Cerrik nga Njësia e Integritit Evropian në kuadrin e integritit në Be janë si më poshtë:

1-Ne datën 11.4.2018 është zhvilluar një sesion informues në gjimnazin "Miranda Baku" në Gostimë, Bashkia Cerrik. Nxënësit e klasave të 12-ta u njoftuan për hapjen e Këndit të BE-së në Cerrik dhe njëkohësisht u informuan rreth programit të financuar nga BE "Erasmus Plus". Pas aplikimit për nisjen e studimeve universitare, interesi i tyre ishte mjaft i larte rreth mobilitetit që ky program ofron. Broshura dhe informacione të ndryshme u shpërndanë në këtë takim dhe për më tepër do të mundësohet një vizitë e tyre në Këndin e BE-se për informacione të mëtejshme.

2—Në datën 28 shtator 2018 organizohet në Cerrik Nata e Kinemasë Evropiane,ku u shfaq filmi "Trishtimi i Zonjës Shnajder", një bashkëpunim shqiptar e çek, me regji të Piro dhe Eno Milkanit.Ky aktivitet vjen I mbvështetur nga projekti Bashkitë në Evrope në bashkëpunim me Bashkinë Cerrik.

3-Në datën 4 prill 2019 inagurohet zyra me nje ndalesë në Bashkinë Cerrik Në ceremoninë e inagurimit morën pjesë Z.Mario Mariani, Shefi i Bashkëpunimit në Delegacionin e BE-së në Shqipëri; Znj.Romina Kuko zëvendësministre e Brendshme dhe Znj.Limya Eltayeb Përfaqësuesja e Përhershme e UNDP në Shqipëri.

Nëpërmjet këtij sistemi arrijmë një përmirësim thelbësor të mënyrës së ofrimit të shërbimeve administrative nga qeveritë vendore, duke reduktuar ndjeshëm kohën, burokracitë dhe distancat për qytetarët. Gjithashtu nëpërmjet sistemit rritet transparenca në ofrimin e shërbimeve, duke kapërcyer çdo pengësë në kthimin e përgjigjeve tek qytetarët nëpërmjet kontrollit të praktikave online.

Sistemi informatik i Zyrës me një Ndalesë është një nga aktivitetet kryesore të projektit Star 2.

4-Në datën t 22 prill 2019 u zhvillua në Cërrik, një aktivitet promovues i Ditës Ndërkombëtare të Tokës, duke sjellë në vëmendje të qytetarëve por edhe të strukturave të ndryshme qendrore dhe vendore, rëndësinë që ka ruajtia e mjedisit dhe menaxhimi i mirë I tokës, në këtë pjesë të Shqipërisë, të konsideruar tejet të frytëshme dhe të pasur me kultura të ndryshme.

Ky aktivitet i realizuar nga Bashkia e qytetit, në bashkëpunim me projektin “Bashkitë për në Evropë” si dhe nën vëmendjen e këndit të BE në qytetin e Cërrikut, u fokusua tek rëndësia që ka për rajonin e Cërrikut mirëpërdorimi dhe ruajtia e tokës.

Në pjesën e dytë, aktiviteti vijoi me një punishte pikture të organizuar me fëmijë nga artisti Kosta Zhonga. Gjatë kësaj pjese të ditës fëmijët patën mundësi që me ndihmën e artistit të krijojnë objekte zbavitëse dhe lojëra me materiale të riciklueshme.

Dita Ndërkombëtare e Tokës është një ngjarje mbarë botërore e cila përkujtohet në shumë vende të ndryshme me forma të larmishme aktiviteteve. BE i kushton kësaj dite nje vëmendje të theksuar, ndaj dhe evenimenti i mësipërm, i zbatuar nga projekti Bashkitë për në Evropë dhe këndi i BE Cërrik, vjen si rrjedhojë e kësaj vëmendje.